REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-13513
Dt.31.07.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Lorik Sylhasit,** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor , me etazhitet B+P+6+Ksh, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: Lorik Sylhasit nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urbanistik "Parku i Qytetit dhe segmenti veripërendimor i rrugës Tirana" dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07/351 - 26155 të datës 22.06.2016, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 4501/74 , ZK: Gjakovë – J.Qytet, në pronësi ½ Lorik (Avdullah) Sulhasi dhe ½ Shkendije (Luan) Sylhasi, në rrugën Ferid Domi, të cilat kanë vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objekit është **B+P+6+Ksh**, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit **S=2027.58 m²**

Bodrumi:	**(Sip.Bruto): .....**	**S=208.80m²**
Përdhesa:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=150.30 m²**
Kati i parë:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=236.32 m²**
Kati i dytë:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=236.32 m²**
Kati i tretë:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=236.32 m²**
Kati i katërt:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=236.32 m²**
Kati i pestë:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=236.32 m²**
Kati i gjashtë:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=236.32 m²**
Kulmi i shfrytzueshëm	**(Sip,Bruto): .....**	**S=250.56 m²**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore "SYLHASI" - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Lorik (Avdullah) Sylhasi nga Gjakova, me banim në rrugën "Mithat Frashëri", p.n., ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-13513, dt. 26.052017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me etazhitet B+P+6+Ksh, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr.4501-74, ZK: Gjakovë –J. Qytet, në pronësi të ½ Lorik (Avdullah) Sulhasi dhe ½ Shkendije (Luan) Sylhasi, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500, të datës 29.04.2016, i punuar nga NPSH"Geogaus"-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 31.05.2017, në pronësi të të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 2703-17, të datës 26.05.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit banimor shumë banesor me nr. 351 - 26155, në ngastrën kadastrale me nr. 4501/74, ZK: Gjakovë- J.Qytet, të datës 22.06.2016
5. Lejen Mjedisore Komunale Nr.07/351/01-14046 dt.30.06.2017 lëshuar nga DUM
6. Raporti mbi kërkimet Gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afaristo banesor, me Investitor Lorik Sylhasi nga Gjakova, në ngastrën kadastrale me nr. 4501/74, të hartuar nga "Geomerkur" Sh.p.k.Gjakovë.
7. Pëlqimin nga Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural nr.08-320/01-14909 dt.15.06.2017
8. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.97/17 me datë 22.05.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme e R.K.S.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr. 430-H-167 të datës 26.05.2017
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me nr.683, dt. 19.04.2017.
11. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.-Gjakovë, me nr.1268, dt.02.05.2017.
12. Pëlqimin nga PTK- Sh.A. Gjakovë, nr. 19 të datës 11.04.2017.
13. Pëlqimin nga Ngrohtorja e Qytetit Nr.212 dt.13.04.2017
14. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Unioni Financiar Prishtinë, filiali në Gjakovë, të datës 28.07.2017.
15. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja projektuese ndërtimore "SYLHASI" - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 8644.30 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit ,**
- **Arkivës.**

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

U. D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË
Kom. kad:Gjakovë-Jasht-Qytet
Parcela nr. 4501/74

PLAN SITUACIONI



Gjakovë;
22.06.2016

Vërteton urb.
Nesrete Ajronil.D.A.

29. Prill 2016v.
Takeometri pregize
Auto CAD 2008

P = 1 : 500

Punoi : N.SH. "Geogauss" Gjakovë
DREJTORI
Xhelil Tertini gjeom.

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe komasacion

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë-Jasht-Qytet

Shk. zvog. 1: 500

Poseduesi: 1 /2 Sylhasi Lorik (Avdullah),1 /2 Sylhasi Shkendije (Luan), nga Gjakova



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m²	
4501/74		Nakarade	Pemisht	2	0	05	00	
Gjithësejtë					0	05	00	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 31.05. të vitit 2017

VËRTETON: